

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA
DEPARTAMENTI PIKTURË**

**PROGRAM STUDIMI
MASTER NE MESUES ARTI**

VITI AKDEMIK 2015 - 2016

TIRANË, 2015

**PROGRAM STUDIMI MASTER NE
"MESUES ARTI"
(ME KOHË TË PLOTË)
KOHEZGJATJA - 2 VJET 120 KREDITE**

Stafi Akademik i Programit dhe Komiteti shkencor
Doktor Nderkombetar Rezarta Zaloshnja

Prof. Vladimir Myrtezai Grosha

Prof. Gazmend Leka

Lektor Altin Lika

Prof. Asc. Carlo Cappa

Dr. Nderkombetar Gemma Errico

Koordinator i programit: **Doktor Rezarta Zaloshnja**

Struktura Didaktike e ciklit mastër dyvjeçar

Program Përmbledhje

Master Mesues Arti

a) Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

Ky Master lind si rrjedhojë e besimit të plotë që arti, tashmë, luan një rol të vlefshëm në ndertimin, strukturimin e dijeve dhe të kulturës sonë. Pra një mundësi dhe një përgjegjësi për ata që duan të ndjekin rrugën e Mesuesit të Artit Pamor, i cili mundeson që nepermjet punës së tij të pasuroj më tej jetën e shoqërisë.

Roli që zë edukimi artistik në programin e arsimit, kurrikules dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, paraqet mundësi për studentet që perfundojnë Masterin në Mesuesin e Artit Pamor, të kryejnë një program formimi që i lejon të zhvillojnë aftësinë e tyre për të punuar në nderthurjen e teorisë (leksioneve, seminareve) me praktikën (laboratore arti, praktike në shkollë) e më tej, dhe i ofron studenteve mundësinë për hyrjen në tregun e punës.

Duke perftuar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë edukatorët e artit, ata, njëherazi, janë të informuar por dhe reflektues të afte për tematikat që tërheqin vëmendjen në binomin e ngushtë të artit dhe të edukimit.

Masteri ndjek të njëjten rrjedhë, tashme të konsoliduar në Universitetin e Arteve brenda një komuniteti hulumtuesish të gjallë dhe bashkëpunues, që fokusohen në metodologjitë, në përmbajtjen, praktiken e arteve pamore dhe rendesinë e tyre në kulturë dhe në shoqëri. Kërkohej të inkurajohet përmes formimit dhe trajnimit të mësuesve të së ardhmes, hulumtimi në të gjithë botëkuptimet (teorike dhe praktike) që përqendron vëmendjen në tematika themelore për zhvillimin e shoqërisë të së ardhmes në horizontin e edukimit përmes artit.

Qëllim është realizimi i një arkitekture me bazë dijes që janë të pasura me njohuri disiplinore dhe ndërdisiplinore për të inkurajuar formimin e mësuesve të artit në tematika si: rendësia e edukimit artistik në stadet e ndryshme të njeriut (grupmosha të ndryshme); rendësia e tij në formimin e një shoqërie që bazon eksperiencën në mendimin krijues; rendësia e edukimit artistik për krijimin e një identiteti kulturor kombëtar por dhe të një identiteti multikultural; rendësia e edukimit artistik për vlersimin e trashigimisë kulturore.

Vëmendje e vecante do të kushtohet perspektivës kritike - analitike të kontekstit historik të programeve mësimore të shkollës e më tej, të reformave të kurrikulës në përgjithsi dhe për artin pamor në veçanti, pra, në projektimin dhe aplikimet e tij në metodologjinë pedagogjike të edukimit nëpërmjet artit, si teori dhe praktike.

Ky program formimi arsimor do të përqendrohet në: perceptimin dhe njohjen, studimin e teknikave dhe aplikimet praktike të artit; ndryshimit të konceptit të artit me nderhyrjen e teknologjisë dhe kultures virtuale; raportit të teorisë dhe praktikës në mesimdhënie dhe në nxënie të artit; perceptimi historik – filozofik i estetikës (midis së kaluarës e së ardhmes).

Do të thellohen, përmes një cikli leksionesh por dhe laboratorësh, kontekste më të gjera teorike dhe filozofike të lidhura me edukimin artistik dhe me projektimin e këtyre dijeve në praktikën e kurrikulumit. Vënd të veçant do të ketë pasqyrimi i mendimit shkencor bashkëkohor, aplikimet, arritjet dhe dilemat e shfaqura nga studiues të ndryshëm në

vlerat që mbartin praktikat artistike në arsimimin dhe formimin e njeriut në shoqëri dhe se ardhmes.

Masteri Mesues i Artit do të jetë në gjendje të ofroj kualifikimin e nevojshëm për të fituar profilet e mëposhtme profesionale:

- Ekspert në fushat e mësimdhënies për edukimin përmjet artit, të trashëgimisë kulturore, të historisë së artit pamor, në përputhje me dispozitat për autonominë e organizimit të mësimdhënies;
- Ekspert për hartimin e projekteve për përdorimin e muzeut/galerisë si një mjedis edukativ i artit dhe i kultures, në kuadrin dhe projekteve për trajnim profesional, të mbështetura nga institucione shtetërore të nivelit qendror e rajonal ose/dhe subjekte jo shtetërore.
- Ekspert për hartimin dhe projektimin e ndërhyrjeve në mësimdhënien e artit apo/dhe të trashëgimisë kulturore, të financuara nga shteti apo organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Masteri Mesues Arti ka për qëllim të sigurojë formim të specializuar për metodat dhe teknikat e komunikimit dhe të përcjellë aftësitë artistike dhe profesionale, për të arritur formimin e përshtatshëm për komunikimin e trashëgimisë artistike dhe kulturore, si në kuptimin arsimor por edhe thjesht informativ. Studentët do të fitojnë një arsimim të përshtatshëm për: transmetimin e kodeve, formave/gjuheve të artit; të interpretimit të veprës; të përdorimit të mjeteve për të hartuar forma përcjellje të duhura të informimit për qëllimet dhe kontekste artistike specifike.

Mbi këtë panel studenti ngre hipotezat e tij me të thella për të qenë në gjendje të mbrojtë, nëpërmjet një punimi studimor shkencor, diplomimin në master të nivelit të dytë dhe të marrë një diplomë si mesues arti.

Disiplina e mësimdhënies

Gjuha multidisiplinore e këtij Masteri parashikon që studimin e thelluar në shumë lende për të realizuar një ndërhyrje katërdimensionale, e perceptuar si më poshtë:

- Të fitojë aftësitë për mësimdhënien teorike e praktike të artit;
- Të planifikojë një ndërhyrje kurrikulare për edukimin artistik;

- Te njoh psikologjine e grupmoshave te ndryshme ne komunikimin e studimin e artit dhe te historisë se artit në shkolla;
- Te fitoje aftesine e projekteve te laboratoreve te edukimit artistik duke ndihmuar ne formimin kulturor te brezave te ardhshem (permes shenjes grafike, ngjyrave, te perdorimit te teknikave dhe te mjediseve multimediale te mesimdhenies) si dhe ne komunikimin e trashëgimisë artistike e kulturore.

Programi dyvjeçar i studimeve Master “Mesues Arti” krijon mundësinë e specializimit më të ngushtë në keto drejtime:

1. Pedagogjia dhe Edukimi i Artit
2. Pedagogjia e Pergjithshme
3. Teoria e perceptimit dhe psikologjia e imazhit dhe e formes
4. Projektimi i edukimit artistik permes shenjes grafike, vizatimit, piktures, etj.
5. Projektimi i edukimit artistik permes multimedias, etj.
6. Histori Arti
7. Estetike
8. Filozofi
9. Përdorimi i teknologjise ne ambientet virtuale të të nxënit për mesimdhenien e artit

Disiplina me zgjedhje:

1. Njohuri kompjuterike
2. Antropologji kulturore
3. Shkrim Akademik
4. Psikologji edukimi dhe komunikimi
5. Anglishte e përparuar

Praktike mesimore:

1. Stazh aktiv / vëzhgimor ne institucione arsimore, muze, galeri, etj.
2. Laborator / mbështetje dhe integrim ne shkollora e organizzata.

Në përfundim të këtij programi dyvjeçar, studenti mbron diplomën me një projekt konkret në një nga drejtimet teknikat dhe perparsite e trajtuara prej tij gjatë dy viteve, e përzgjedhur nga pedagogët në procesin e punës duke patur parasysh prirjen individuale të secilit.

Diploma shoqërohet edhe me një studim teorik, në lidhje të ngushtë me subjektin dhe teknikën e realizimit të projektit.

b) Mundësitë për punësim

Të diplomuarve në Mesues Arti, përmes këtij formimi, u jepet mundësia të behen udhëheqës të projekteve arsimore në shumë kontekste si: instituzione arsimore, galeri arti, muze, organizata të artit në komunitet, agjensi qeveritare; të jenë mesues arti në shkolla publike e private; të kenë aftësi menaxhimi për zhvillimin e strategjive të reja mësimore të cilat bazohen në vlerat që mbart arti. Njëherazi, u jepet mundësia të ndjekin studime të mëtejshme pasuniversitare për të thelluar dijet e tyre në këto fushë.

Studentët në këtë Master do të jenë të inkurajuar për të qenë pjesë aktive në mediumet ku shqyrtohen çështjet e mësimdhënies së artit, të programeve mësimore e reformave të kurrikulave, të trajnimit të mësuesve dhe marrjes së një roli aktiv në reformat e sistemit arsimor në shkollat urbane dhe rurale duke konsideruar kontekstet e decentralizimit.

Diploma e Master-it në Mesues Arti është projektuar për të formuar dhe për të krijuar mundësi edhe mësuesve që praktikojnë aktualisht mësimdhënien e artit në shkolla, për të ndjekur një program studimi që lejon pasurimin e dijeve dhe zhvillon kompetencat e tyre në: planifikimin e edukimit artistik në kontekstin e kurrikulës dhe zhvillimin e teknikave që lidhen ngushtë me mësimdhënien e artit e të lëndës së historisë së artit.

Në këto aspekte Masteri në Mesues Arti do të frymëzojë, të angazhojë dhe të formojë edukatorë, të cilët me përgatitjen e tyre, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nevojat e nxenesit, të shollës, të familjes dhe të ambientit që i rrethon, kanë aftësi të modelojnë, nderhyjnë në kurrikulën e shkolles por dhe të ndërtojnë projekte që për bazë kanë artin.

TABELAT PËRMBLEDHËSE TE PLANIT MËSIMOR NE MASTER-IN MESUES ARTI. (shenim tabela ne Excel eshte e bashkangjitur)

.....

Strategjitë për arritjen e objektivave

Objektivi është realizimi i një arkitekture me bazë dijesh që janë të pasura me njohuri disiplinore dhe ndërdisiplinore për të inkurajuar formimin e mesuesve të artit në tematika si: rëndësia e edukimit artistik në grupmoshat e ndryshme; rëndësia e tij në formimin e një shoqëri që bazon përvojën në mendimin krijues; rëndësia e edukimit artistik për krijimin e një identiteti kulturor kombëtar por dhe të një identiteti multikulturor; rëndësia e edukimit artistik për vlersimin e trashigimisë kulturore.

Vëmendje e veçantë do të kushtohet perspektivës kritike - analitike të kontekstit historik të programeve mësimore të shkollës e më tej të reformave të kurrikulës me referencë të veçantë për artin pamor në përgjithsi dhe atë bashkëkohor në veçanti, pra, në projektimin dhe aplikimet e tij në metodologjinë pedagogjike, si teorike ashtu dhe praktike.

Ky program formimi arsimor do të vëre theksin në: perceptimin dhe njohjen, studimet e teknikave dhe aplikimet praktike të artit; ndryshimet të konceptit të artit me nderhyrjen e teknologjisë dhe kultures virtuale; raportin të teorisë dhe praktikës në mesimdhënie dhe në nxënien e artit; perceptimi historik – filosofik i estetikës.

Marredhëniet ndër institucionale ndërkombëtare me shkolla analoge

Ambicia jonë është të jemi pjesë e konvertueshme në vlerat e komunikimit me programe që vëre theksin në vlerat që mbart edukimi përmes artit dhe të jemi afër lidhjeve europiane e më gjerë në format e pershtatshme të kooperimit përmes studimeve e konferencave të përbashkëta.

Tendenca jonë vlen për të promovuar shkëmbime të ndërsjellta me organizma të specializuara e të konsoliduara në Nderkombetare e ne vecanti ato te Bashkimit European. Ky bashkepunim mund te shihet dhe me prezencen ne stafin akademik te profesoriatit te ftuar nga universitete te ndryshme europiane, qe e propozojme per tu konkretizuar edhe ne kete program.

Do te synohet, per te bejre shkëmbime te ndërsjellta studentësh, pedagogësh për te mundesuar shkembimin e dijeve dhe njohjen e metejshme të vlerave që mbart cdo kulture.

Ne kete kuader do te jete edhe mundesimi i prezences në programet e «Erasmus Mundus» si një tjetër organizëm për të menaxhuar ndërkomunikimin kulturor në një hapsirë gjeografike pa kufij.

Organizimi i Mësimdhënies

Objekti i stafit akademik është të monitoroj dhe të aktivizoj procese gjithëpërfshirëse ne praktikat mësimore, përmes temash që organizohen në atelie (projektet e zhvilluara ne forme laboratoresh arti) dhe ne auditorim.

Vemendje do ti kushtohet analizës, bashkebisedimit ne auditoriumet universitare dhe ne praktiken laboratorike.

Monitorimi i studenteve do te perfshije: angazhimin, zgjedhjen e tematikave dhe mjeteve per realizimin e laboratoreve te edukimit artistik; krijimit të medimeve me të cilat studenti shprehet dhe realizon idete e paraqitura dhe ndertimin e nje projekti duke i siguruar autonomi por edhe prezence me udhëzime e materiale didaktike te pergjedhura nga stafi akademik per arritshmerine dhe funksionalizmin ne nxenie e ne praktike.

Ky synim do te arrihet ne te gjitha veprimtarite qe do te zhvilloje studenti me nje komponent te larte verbal e tekstual, duke u mbeshtur ne material vizual per nje rritje te ndjeshme te informacionit (nga disiplinat shkencore dhe/apo prezantimet vizuale te koncepteve apo ngjarjeve te tjera); duke zgjedhur nje rruge nderveprimi me

informazione dhe praktike qe terheq vemendjen ne nxenien e dijeve ne dimensione te gjithëaneshme.

Stafi akademik qe ka per qellim kryesor rritjen e vazhdueshme te cilesise se mesimdhënies, per te testuar nëse strategjite e mësimdhënijes kane sjellë rezultatet e deshiruara dhe efektive, do te kerkoj nga studenti dorzimin e detyrave qe jane te formave te ndryshme: përshkrimi i vëzhgimeve te bera ne praktik, analize te teksteve te sygjeruara, ilustrime me shembull te modeleve te edukimit permes artit dhe te artit ne ambiente te ndryshme.

Identifikimi i profileve profesionale

Të diplomuarit ne kete Master do të jetë në gjendje të kryejne aktivitete profesionale në institucione të ndryshme si publike dhe private, si specialistë qe janë në gjendje të operojnë me fleksibilitet dhe autonomi në sektorë të ndryshëm te arsimit dhe të trashëgimisë kulturore.

Stdimi ne kete Master mundeson arritjen e profilit profesional të edukatorit per artin pamor ne galeri apo/dhe muze, te specialistit per organizimin dhe hartimin e projekteve arsimore për artin, si dhe drejtimin e komunikimin ne media te programeve te natyres edukative artistike.

Kërkesat e pranimit për Master-in Mesues Arti

I hapur për të gjithë studentët shqiptar dhe nderkombetar që kane perfunduar një Diplomë te nivelit të parë apo/dhe studentë qe kane mbaruar sistemin 4-vjecar ne Akademitë e Arteve te Bukura apo/dhe Universitetet e Artit, me kualifikime ekuivalente artistike dhe e njohura ne baze te marveshjeve nderkombetare. Per shtetet Bashkimit

European pranohen diplomat qe permbushin kushtet e mesiperme dhe regullohen ne baze te Procesit te Bolonjes.

Konkurrimi dhe numri i studenteve

Kursi Masterit përfshin një numër të programuar prej studentesh. Pranimi i nënshtrohet një interviste nga një komision i posaçëm qe eshte pjese e departamentit te Masterit.

Studentët qe vijnë nga nje cikël studimi jo artistik, mesuesit qe aktualisht ushtrojne detyren e mesuesis ne profilin e artit pamor dhe histori arti i neshtrohen te njejtave kushte te pashtruara me siper.